Ndryshimet në numrin njëjës ndeshen në rasat e drejta dhe të zhdrejta. Përgjithësisht bëhet fjalë për ndërrimin e fonemës

³⁴ Po aty, f. 93, §36, d, shënim.

³⁵ Ndonëse rezultati është në dukje i kundërt, të dy leksemat i përshtatet normës drejtshkrimore për format e shquara të emrave femërorë që dalin më zanore të theksuar (po aty, f. 75, §25, b).

fundore tematike *-e* me *-ë*: 552 *ijën*, 568 *ijë* (kallëzore)] 536 *ijen*, 550 *ije* (FD: 251); 547 *e shtrojës*] 531 *e shtrojës* (FD: 639), por ndeshet edhe fenomeni i kundërt, si te 395 *pasdites*] 383 *pasditës* (FD: 468).

Edhe më të shpeshta janë korrigjimet normative të shumësit të emrave, që realizohen me këmbimin e morfemës *-e* me morfemën *-ë*: 299 *shandanët*] 293 *shandanet* (FD: 607); 461 *silurëve*] 448 *silureve* (FD: 582); 496, 557, 559 *ijët*, 501 *ijë* (kallëzore)] 481, 540, 542 *ijet*, 486 *ije* (FD: 251); 523 *frakëve*] 508 *frakeve* (FD: 192); 572, 576 *qilarët*] 555, 558 *qilaret* (FD: 538); ose të morfemës *-e* me *-a*: 320 *kapela*] 312 *kapele* (në FD: 276 të dy format e shumësit janë normative; forma *kapele* shënohet te zëri *kapelë*; më pas gjuha letrare, nga FGJSSH: 783, përdor vetëm variantin *kapelë*); 405 *xunktha*] 393 *xunkthe* (FD: 710); 551 *kioskat*] 535 *kiosket* (leksema e përdorur nga Kadare për herë të parë në B¹.73 ende nuk është regjistruar në fjalorët shpjegues. Ndërrimi morfematik përlligjet, sepse forma e njëjësit *kioskë*, sipas rregullave të formimit të shumësit të emrave femërorë në gjuhën shqipe, del në shumës me morfemën *-a*); 419 *zhgunave*, 570 *zhguna*] 406 *zhguneve*, 552 *zhgune* (FD: 729).

Krahas zëvendësimit të morfemës *-ë* me *-a*: 223 *mikrofonat*] 218 *mikrofonët* (FD: 391), ndeshet edhe veprimi i kundërt i ndërrimit të morfemës *-a* herë me *-ë*: 551 *furgonët*] 534 *furgonat* (italianizmi i përdorur në B².77 do të regjistrohet vetëm në 2002: 367) e herë me *-e*: 285 *tubete*] 279 *tubeta* (italianizmi *tubet* nuk regjistrohet në fjalorët shpjegues); 373, 401, 423 *pasdarkeve*] 362, 389, 410 *pasdarkave* (FD: 467).

Po nga kategoria e emrit vërehet këmbimi i afiksit të vjetëruar, e për më tepër dialektor, *mbas-* me *pas-*, i parapëlqyer nga gjuha letrare: 72, 191, 300 *pasdite*, 226 *Pasdite*] 71, 187, 294 *mbasdite*, 221 *Mbasdite* (FD: 468).

Ndodh që ndërrimi i gjinisë të përcaktohet nga konteksti, si 80 *ndežësin*] 79 *ndežësen* (FD: 412), sepse bëhet fjalë për

‘mekanizmin a pjesën e posaçme, që shërben për t’i dhënë zjarr një granate’, pra për një emër të gjinisë mashkullore dhe jo për një mbiemër femëror të emëruar (pas përshtatjes me një emër femëror).

Eliminimi i prapashtesës -s në rastin e emrit 563 *puthador*] 545 *puthadors* (FD: 530) nuk e komprometon kuptimin e fjalës, sepse tregon cilësinë ‘lajkatar, servil’ të emrit dhe jo vepruesin (!), që ka këtë cilësi (forma me -s nuk ekziston në shqipe).

Nga kategoria e mbiemrit vërehet përdorimi i prapashtesës normative në 242 *dykrenore*] 236 *dykrenare* (FD: 152) dhe mënjanimi i prapashtesës në 498 *të ndërsjellë*] 483 *të ndërsjelltë* (FGJSSH: 1212). Respekton normën edhe korrigjimi i mbiemrit pronor që shoqëron emrin e farefisnisë *atë*: 327 *të tyt eti*] 319 *të tët eti*, sepse rasa e kërkuar nga konteksti nuk është rasa kallëzore por gjinore (siç e tregon qartë nyja).

Nga kategoria e foljes mund të veçohet korrigjimi i paradigmës së foljes *ndiej*: 284, 368, 453, 483, 531 *u ndie*, 371 *ndiente*, 535 *kishin ndier*] 278, 358, 440, 469, 515 *u ndje*, 360 *ndjente*, 519 *kishin ndjerë* (FD: 415) dhe i së pakryerës së habitores së foljes *kam*: 424 *paskëshim*] 411 *paskeshim* (FD: 272). Karakteristik është edhe shtimi i mbaresës vetore në format e shkurtra të së pakryerës së dëftores për foljet ndihmëse *kam* e *jam*: 29 *kishte*] 31 *kish* (FD: 272); 583 *ishte*] 565 *ish* (FD: 260).

Për kategorinë e ndajfoljes vërehet mënjanimi i morfemës fundore sipas normës: 77 *asgjëkund*] 76 *asgjëkundi* (FD: 45). Në rastin e variantit 521 *verbazi*] 506 *verbtazi*, përzgjedhja diktohet gjithmonë nga norma, që regjistron vetëm *verbazi* (FD: 693). Por duhet thënë se ndajfolja e mënjeluar *verbtazi* del si variant dytësor, bashkë me *verbazi*, te zëri *verbas* në FGJSH: 1166; pra fillimisht nuk është variant i normës drejtshkrimore dhe vetëm më vonë pranohet nga gjuha letrare.

1.1.3. *Ndryshime drejtshkrimore*

Përdorimi i theksit si shenjë dalluese është i kufizuar në gjuhën shqipe. Mund të tregojë gjatësinë e zanores: 43, 479 *dhé* (emër)] 44, 465 *dhe* (lidhëz), ose theksin e fjalës: 63 *pará* (emër)] 63 *para* (parafjalë), duke shmangur njëkohësisht interpretime semantike të gabuara të tekstit. Por kjo rregull nuk vlen në roman me zërin 561 *pré]* 544 *pre*, i cili është shënuar vetëm një herë në fjalësin e fjalorëve shpjgues. Ndonjë fjalë oksitone shënohet me zanoren e theksuar për të siguruar ‘shqiptimin e drejtë të saj’ (DGJ: 70, §21) si pjesëza 127 *palé]* 124 *pale*, por ndeshet edhe veprimi i kundërt, i përshtatshëm, për foljen 533 *u ridha]* 518 *u ridhá*, që vështirë të ngatërrohet në shqiptim (parashtesa nuk ka asnjëherë theks).

Ndërhyhet te huazimet ose fjalët e krijuara brenda gjuhës nga rrënjë leksikore të huaja, që kanë grupe zanore *-ia-* dhe *-ie-*, të cilat shkruhen me *i*, edhe kur kjo e fundit është e pakteksuar: 193 *bukureshtiane]* 190 *bukureshtjane*; 468 *portieri]* 454 *portjeri* (DGJ: 90-91, §36, a). Për emrat e përveçëm me *ej* në trup të fjalës përdoret gjysmëzanorja *j*, si 156 *Cejloni]* 154 *Ceiloni*; po kështu korrigjohet me të drejtë zanorja *u* në *ë* sipas shqiptimit (dhe jo grafisë origjinale) të emrit 373 *Çërçilli]* 363 *Çurçilli* (khs. me anglishten Churchill).

Respektojnë normën leksemat: 186 *gjysmë]* 183 *gjysëm* (FD: 229); 439 *prozhëm]* 427 *prozhmë* (FD: 525).

Përdoren shkronjat e mëdha për emërtime organizatash politike: 340 *Parti*, 340, 348 *Partisë*, 357 *i Partisë]* 331 *parti*, 331, 338 *partisë*, 347 *partisë*, dhe institucionesh: 422 *Komitetit të Partisë]* 409 *komitetit të partisë* (DGJ: 151, §80). Po ashtu mënjanohet shkronja e vogël për emërtime me emra të përgjithshëm që në kontekst janë të barasvlershëm me emrat e përveçëm: 161 *komandanti i Korpusit 53]* 159 *komandanti i korpusit 53*; 241, 563 *Bulevardi i Madh*, 246, 275 *Bulevardin e Madh*, 484 *Bulevardit të Madh]* 235, 546 *bulevardi i madh*, 240, 270 *bulevardin e madh*, 470 *bulevardit të madh*; 570

Sallës së Koncerteve] 553 *Sallës së koncerteve* (DGJ: 142, §70).

Zëvendësohet shkronja e vogël në emërtimin e trupave qiellorë: 337 *Hënës*] 329 *hënës* (DGJ: 147, §77), në cilësorët e emrit të një vendi: 415 *Zelanda e Re*] 402 *Zelanda e re* (DGJ: 148, §78), dhe në emrat e anëve të horizontit: 161 *kundëradmirali i Veriut*] 159 *kundëradmirali i veriut* (DGJ: 149, §78, shënim 4).

Me të madhe është regjistruar titulli fetar *pashë* kur është përdorur si pjesë e pandarë e emrit të përveçëm: 433 *Ali Pashait*, 434, 435 *Ali Pashai*] 420 *Ali pashait*, 420, 421 *Ali pashai* (DGJ: 144-145, §73).

I përket sferës fetare dhe emërtimi: 502 *Testamentit të Vjetër*] 487 *testamentit të vjetër*, që përdor shkronjën e madhe për togfjaëshin emëror, megjithëse FGJSSH: 1989 regjistron me të madhe vetëm emrin *Testament* dhe me të vogël mbiemrin cilësor, normë që ndoshta do të ishte e përshtatshme të rishikohet nga drejtshkrimi i gjuhës shqipe.

Përdorimi i shkronjës së madhe pas dy pikave është normativ vetëm nëse fillon një ligjëratë e drejtë a citim. Në rastet e mëposhtme fillon një citim, pra përdorimi i shkronjës së madhe është i përshtatshëm (pavarësisht faktit që citimi nuk vihet në thonjëza): 171 *njeriu: Pas*] 168 *njeriu: pas*; 188 *tym: Alo,*] 185 *tym: alo,*; 325 *mendoj: Më*] 318 *mendoj: më*; 349 *pyetjen: Shoku*] 339 *pyetjen: shoku*; 427 *fjalët: Popull*] 413 *fjalët: popull* (për të gjithë shembujt khs. DGJ: 160, §95).

Korrigjime të tjera përsfshijnë përdorimin e shkronjës së vogël. Ajo ka zëvendësuar me të drejtë shkronjën e madhe në emërtimin e funksioneve shtetërore: 542 *presidentin e Republikës*] 526 *Presidentin e Republikës* (DGJ: 144, §73) dhe të qarkores informuese: 271 *buletinin e verdhë*] 266 *Buletinin e verdhë*.

Ndërhyrje të shumta hasen në shkrimin e fjalëve njësh, ndaras dhe me vizë në mes. Shkruhen njësh emrat e përbërë

me lidhje përcaktore midis gjymtyrëve: 458 *gjysmëdremitjeje*] 445 *gjysmë dremitjeje* (DGJ: 124, §67, A b) dhe kompozitat mbiemërore me elementin e parë *ngjyrë-* të ndjekur nga një emër në rasë të drejtë: 28 (sipërfaqen) *ngjyrëkafe*, 33 (orenditë) *ngjyrëkafe*, 394 (hapësirën) *ngjyrëkafe*] 29, 35, 383 *ngjyrë kafe* (për këtë tipologji mbiemërore khs. shembujt e ngjashëm në FD: 431 dhe për shkrimin ndaras të togfjalëshave emërorë me kuptim mbiemëror khs. DGJ: 129, §67, B a).

Për kategoritë e tjera gramatikore mund të përmendet korrigjimi i grafisë së përemrit të pakufishëm: 109, 155, 157, 214, 224, 241, 247, 348, 562, 569 *njëfarë*] 107, 153, 155, 210, 219, 235, 241, 339, 545, 552 *njëfarë* (FD: 437), të pasthirmave: 330 *Upupu*] 322 *U pu pu* (DGJ: 128, §67, A ç) e 492, 527 *oburra*] 478, 512 *o burra* (FD: 442) dhe të lidhëzave: 75 *përveçqë*] 74 *përveç që*; 33 *përveçse*] 34 *përveç se*; 159 *Veçse*] 157 *Veç se* (DGJ: 128, §67, A ç).

I veçantë është rasti i ndajfoljes 326, 462 *mespërmes*] 318, 449 *mes për mes*, e cila sipas DGJ: 130, §67, B c, që e konsideron lokucion ndajfoljor, duhet shkruar ndaras. Leksema fillon të shkruhet njësh që nga FSHS: 771. Pra norma drejtshkrimore është kapërcyer.

Për shkrimin ndaras të numërorëve themelorë regjistrohen dy shembuj: 303 *njëzet e tetë vjeç*] 296 *njëzetetëtvjeç* (për numërorin khs. DGJ: 126, §67, A ç dhe për mbiemrin *vjeç*, po aty: 87, §31, shënim); 370 *njëzet e tre e pesë*] 359 *njëzetet e pesë* (DGJ: 126, §67, A ç).

Regjistrimi i numrave me shkronja në vend të shifrave është zgjedhje e autorit dhe nuk ka të bëjë me normën drejtshkrimore: 315 *rreth orës njëzet e dy*, 437 *në orën dhjetë*, 564 *në orën dymbëdhjetë*] 307 *rreth orës 22*, 425 *në orën 10*, 547 *në orën 12*; 370 *tridhjetë e një vjeç*] 359 *31 vjeç*; 320 *viteve tridhjetë*, 559 *vitet tridhjetë*] 312 *viteve 30*, 542 *vitet 30*.

Është e përshtatshme gjithashtu ndarja e lidhëzës: 304 *qysh se*] 297 *qyshse* (FD: 541) dhe e ndajfoljes: 523 *së bashku*] 508 *sëbashku* (DGJ: 130, §67, B b).

Shkrimi ndaras i pjesëzës *seç* nuk respekton normën drejtshkrimore: 113 *Beni se ç'kishte folur*] 111 *Beni seç kishte folur*; 327 *Ajo se ç'i tregoi*] 319 *Ajo seç i tregoi* (DGJ: 128, §67, A ç); ndërsa përdorimi i përbërësve të saj si fjalë të veçanta (lidhëza *se* e përemri *ç*) bën që ato të shkruhen ndaras: 288 *më shpejt se ç'e mendonte*] 282 *më shpejt seç e mendonte* (po aty).

Edhe në rastin e leksemës me funksion ndajfoljor 159, 489 *një herë*, 261, 334, 391, 518 *Një herë*] 157, 474 *njëherë*, 256, 325, 380, 503 *Njëherë* (FD: 437), norma parashikon shkrimin njësh.

Shkrimi i vizës lidhëse është i përshtatshëm me formimet nga fjalë që përsëriten, si shembulli i përemrit të pacaktuar: 91 *njeriu-njeriut*] 90 *njeriu njeriut* (DGJ: 133, §68, a), i numërorëve themelorë: 555 *tre-katër*] 538 *tre katër* (po aty) ose i numërorëve me përdorim përemëror: 121, 284 *dhjetëra-mijëra*] 118, 278 *dhjetëra mijëra* (po aty), dhe i mbiemrave cilësorë me lidhje këpujore: 186 *amerikano-latinë*] 183 *amerikanolatinë*; 212 *latino-amerikanëve*] 208 *latinoamerikanëve* (DGJ: 135, §68, d).

Shkruhen gjithashtu me vizë emërtimet e përbëra nga dy fjalë që kanë lidhje ndajshkrimore: 508 *radio-postën*] 494 *radiopostën* (DGJ: 134, §68, c) dhe pjesëzën *ish-* para disa emërtimeve, si 110 *ish-pronat*] 108 *ishpronat* (DGJ: 135, §68, dh).

Ndërsa në rastin e leksemës: 284 *Bllokadë*] 278 *Bllok-adë*, regjistrimi me vizë ndarëse i përket B¹.73: 232, i përsëritur deri në B⁴.99, me funksionin e nxjerrjes në pah të rrënjës së fjalës *bllok*. Vetëm në B⁵.08 autori e mënjanon këtë përzgjedhje stilistikore.

Shkurtime e emrave të shteteve janë lakuar si emrat e përgjithshëm, pra marrin treguesin e rasës: 538, 544, 552, 562, 567, 567, 569 *BRSS-së*] 522, 528, 535, 545, 549, 550, 551 *BRSS* (GGJ: 152; DGJ: 138, §68, j).

Nëse vendosja e dy pikave është e nevojshme para citimit të një ligjërate të drejtë në thonjëza: 200 *sikur të thoshte: "edhe*] 196 *sikur të thoshte "edhe*, është i gabuar përdorimi i shkronjës së vogël në fillim të citimit (për të dy fenomenet khs. DGJ: 160, §95).

Forma e shkurtuar e shkruar së gjati: 400 *domethënë*] 388 *d.m.th.*, nuk ndjek një rregull të caktuar drejtshkrimore, por sigurisht është më formale, pra më e përshtatshme për një tekst letrar.

Zërat *dramë* e *ndarje* shkuhen me kursiv në B⁴.99 për të nxjerrë në pah kuptimin e veçantë në kontekst, por grafia me kursiv e tërë togfjalëshit (parafjalë + emër) në B⁵.08 i jep kohezion kësaj gjymtyre gramatikore (rrethanor): 324 *me dramë*] 316 *me dramë*; 324 *me ndarje*] 316 *me ndarje*, po kështu veçohen nëpërmjet kursivit fjalët e huaja që shkruhen me alfabetin e shqipes: 298 *bonzhur*] 291 *bonzhur* (në këto tri raste në këtë punim nuk përdoret kursivi për leksemat e B⁴.99 për të vënë në dukje ndryshimin grafik me B⁵.08).

Së fundi, vihet re se teksti në 295 - 289 *Gjithë rrudhat e tyre...* kalon në kryeradhë, për të ndarë fjalët e autorit nga ligjërata e drejtë e personazhit. Në dy raste të tjera kryeradha eliminohet. Bëhet fjalë për vazhdimin e ligjëratës së drejtë të njëjtit personazh: 327 - 319 – *Babai ...*, dhe për vazhdimin e tregimit të episodit të minës: 453 - 440 *U fut ...*

1.1.4. *Ndryshime sintaksore*

Ndërhyrjet për përshtatjen në gjini të gjymtyrëve të togfjalëshit emëror ndeshen shpesh në roman. Ndodh të korrigjohen gabimet e B⁴.99, si 190 *pirgjet e njohura*] 186 *pirgjet*

e njohur, sepse mbiemri përshtatet me të drejtë me emrin e dygjinishëm *pirg*, por në shumicën e rasteve rishikohen ‘gabimet’ që B⁴.99 i ‘trashëgon’ nga B³.83. Në të vërtetë, pas ndryshimit të njëjive emërore të disa togfjalëshave *emër+mbiemër* të B³.83, B⁴.99 nuk e shqyrton sërishmi përshtatjen e mbiemrit me emrin ‘e ri’. Si rrjedhim, B⁵.08 korrigjon këtë mospërshtatje, si p.sh. në togun 120 *rrembat e kaltërremë*] 117 *rrembat e kaltëreme* (sic), në të cilin mbiemri femëror *e kaltëreme* përshtatet fillimisht me emrin femëror shumë *venat* të B³.83, që më pas, në B⁴.99, zëvendësohet nga autori me emrin mashkullor shumë *rrembat*.

Mund të renditen këtu edhe togjet 138 *Qelqet dyfishë*] 137 *Qelqet dyfish* e 350 *qelqeve, të veshura*] 340 *qelqeve të veshur* (sic), si edhe 411 *Fijet telefonike*] 398 *Fijet telefonikë* e 427 (fijet) *të ndera*] 414 (fijet) *të nderur*, në të cilat variantet fillestare të B³.83 ishin përkatësisht leksemat (mashkullore shumë) *xhama* e *tela*. Në një rast të vetëm: 431 *gazrat sulfurikë*] 417 *gazrat sulfurike*, ndërrimi i gjinisë së mbiemrit (femërore→mashkullore) nuk motivohet nga norma, e cila parashikon për shumësin e disa emrave të lëndës me morfemën *-ra* kalimin në gjininë femërore (GGJ: 92).

Për kategorinë e përemrit përmenden shembujt: 108 *Ata* (sytë)] 106 *Ato* (sytë) dhe 361 *të cilave* (qelqnajave)] 351 *të cilëve* (qelqnajave): korrigjimet zbatojnë normën.

Ndërhyrjet e tjera sintaksore janë: 26 *dalin*] 27 *dilnin*: koha e tashme tregon se veprimi kryhet në momentin e ligjëritimit; 26 *te vijat e bardha*] 28 *në vijat e bardha*: parafjala të shënon vendin pranë të cilit dhe jo në të cilin kryhet veprimi; 65 *midis farmacisë rojë dhe*] 65 *midis farmacisë së rojës dhe*: ndajshtimi zëvendëson përcaktorin që shpreh përkatësi; 89 *e gjitha kjo*] 88 *e gjithë kjo*: mbiemri i pakufishëm përdoret në trajtën e pashquar; 143 *Ja njëra ngjyrë portokalli*] 142 *Ja një ngjyrë portokalli*: përemri i pacaktuar shpreh më qartë veçimin e një objekti (tullumbace) nga të tjerët e të njëjtit lloj; 155

shëndetin e sekretarëve të parë] 153 *shëndetin e sekretarëve të parë të partive të vendeve socialiste*: dihet për ç' sekretarë bëhet fjalë, prandaj eliminimi i përcaktimit të mëtejshëm është i përshtatshëm; 201 *jepini*] 197 *jepni*: në paradigmën e mënyrës urdhërore përfshihet trajta e shkurtër e dhanores; 220 *Ishte si një goditje prej rrafshire*] 215 *Ishte si goditja e një rrafshire*: togfjalëshi ndjek trajtën e pashquar të togfjalëshave të fjalisë pararendëse, si rrjedhim ndërrimi i gjinores me rrjedhoren është i përshtatshëm; 256 *si mund t' u rrinë*] 251 *si mund t' ju rrinë*: korrigohet trajta e shkurtër e përemrit vector (veta e dytë) me atë të vetës së tretë shumës (*atyre, u*); 279 *ishte*] 273 *është*: e pakryera tregon se veprimi i foljes kishte filluar të kryhej në të kaluarën; 290 *Në njëren nga fotografitë*] 284 *Në një nga fotografitë*; 332 *ç' u kishte treguar [...] u kishte ngelur në mendje*] 324 *ç' i kishte treguar [...] u kishte ngelur në mendje*: ndërrohet trajta e shkurtër njëjës (*atij, i*) me shumësin (*atyre, u*) që kërkon konteksti; 378 *Nga ti*] 368 *Nga ty*: rasa emërore zëvendëson formën e gabuar; 430 *të vente [...] të vente*] 417 *të vejë [...] të vente*: harmonizohet koha e foljeve, meqenëse përsëriten të njëjtat fjalë në fjalinë pasardhëse; 489 *o të keqen*] 475 *të keqen-ò*: pasthirrma i paravendoset fjalës; 493 *një tiktaku ore dhe rrezesh*] 478 *një tik-tak ore dhe rreze*: formimi onomatopeik ia lë vendin fjalës së përngjitur e ndjekur nga dy përcaktorë në rasën rrjedhore; 505 (deti) *plot shkulma*] 490 *plot shkulmë*: shumësi zëvendëson njëjësin, sepse deti nuk mund të jetë veçse me shumë dallgë; 545 *në sipërfaqe*] 529 *në sipërfaqen e tij*: eliminohet specifikimi i tepërt me mbiemrin pronor; 582 *të pushonte*] 564 *të pushojë*: veprimi është kryer, prandaj folja regjistrohët me të drejtë në kohën e pakryer.

1.1.5. Ndryshime leksikore

Ndërhyrjet janë të pakta dhe bëhet fjalë kryesisht për zëvendësime fjalësh sinonimike. Për kategorinë e emrit vihet re: 109 *kafene*, 551 *kafenetë*, 563 *Kafenetë*] 107 *kafe*, 534 *kafet*, 546 *Kafet*: leksemat janë të barasvlershme, por zëri *kafene*, përgjithësisht i thjeshtëligjërimit, dallon më qartë *lokalin* ku përgatitet e konsumohet *kaffja*. I së njëjtës familje është edhe shembulli 565 *kafenë*] 548 *kafen*, në të cilin fjala me theks fundor (*kafé*) zëvendëson variantin me theks parafundor (*káfe*).

Lidhet me këtë pije një tjetër ndërhyrje leksikore, që përdor prapashtesën zvogëluese -z: 536 *kupëzën*, 536 *kupëzat*] 520 *kupën*, 521 *kupat*, për të kufizuar referimin nga gota ose tasi, me përmasa e përdorime të ndryshme, tek *ena e vogël* që përdoret kryesisht për të pirë kafe.

Ndër zgjedhjet e tjera sinonimike, për kategorinë e lidhëzave regjistrohen 139 *Por*] 138 *Po*, 283 *edhe*] 277 *dhe*, dhe për kategorinë e parafjalëve: 382 *te ne*, 423 *Te të djathtët*] 371 *tek ne*, 410 *Tek të djathtët* (në dy shembujt e fundit, varianti grafik varet nga tingulli nistor i fjalës ndjekëse).

Ndeshen në roman ndryshime leksikore që diktohen nga konteksti. Eliminohet përemri vector *ai*, meqenëse përsëritet në fjalinë pasuese në shembullin 366 *mendoj. Ai*] 356 *mendoj ai. Ai*. Ndërsa në rastin: 51 *e pyeti ai*] 52 *i tha*, zëvendësimi i foljeve është i drejtë, sepse fjalia, në të cilën regjistrohet folja, është pyetëse jo dëftore.

Interpretimi më i kujdesshëm i togfjalëshave emërorë përcakton ndërrimet në 51 *të telefonave të shefave të zemëruar*] 51 *të telefonave të zemëruar të shefave*, ku del qartë se mërzia është e frymorëve (*shefave*) dhe jo e sendeve (*telefonave*).

Po kështu në togun 365 *takime gazmore*] 355 *mbledhje gazmore*, zëvendësimi i leksemës emërore bën që cilësia e shprehur nga mbiemri të jetë më të realizueshme, sepse është

vështirë që një *mbledhje*, përgjithësisht zyrtare, të jetë *gazmore*, ndërsa një *takim* edhe mund të jetë i tillë.

Nuk mungon dhe shembulli në të cilin arsyeja e ndryshimit leksikor nuk është e mundur të interpretohet. Është fjala për mbiemrin e një personazhi të romanit: 126 *Anastas Lula*] 123 *Anastas Lulo*.

1.1.6. *Ndryshime të shenjave të pikësimit*³⁶

Ndër shenjat e pikësimit, përdorimi i presjes është më i rëndomt.

Ajo përdoret për të treguar një pushim të shkurtër në fjali, duke ndarë fjalë ose grupe fjalësh me funksione të ndryshme, si rrethana vendi: 29 *Atëherë, në Butrint, Zefi*] 31 *Atëherë në Butrint Zefi*; 32 *kishte sjellë [...], që përjashta, shenjat*] 34 *kishte sjellë [...], që përjashta shenjat*, kohe: 37 *Në mbarim të saj, e shoqja*] 38 *Në mbarim të saj e shoqja*; 111 *Më në fund, breshëria mbaroi*] 109 *Më në fund breshëria mbaroi*, ose mënyre: 29 *që, me siguri, nuk do*] 30 *që me siguri nuk do*.

Shtohet presja gjithashtu për të veçuar thirrësin: 408 *Jo, vëlla, unë*] 396 *Jo vëlla unë*, dhe pjesëzat: 50 *se, sidoqoftë,*] 51 *se sidoqoftë*. E përshtatshme është vënia e saj para fjalive të varura mënyrore palidhëzore: 125 *tha Liria, duke psherëtirë.*] 122 *tha Liria duke psherëtirë.*; 346 *të mos ndesh-te..., duke hyrë...*] 336 *të mos ndesh-te... duke hyrë...* .

Me të drejtë mënjanohet presja para lidhëzave bashkërenditëse: 33 *ai nuk e vuri re ose*] 34 *ai nuk e vuri re, ose*; 42 *veshët apo*] 42 *veshët, apo*; 50 *njëri-tjetrin dhe*] 50 *njëri-tjetrin, dhe*, ashtu siç është i drejtë zëvendësimi i saj me pikëçuditëse pas pasthirmave: 331 *Ua! - ia bëri*] 322 *Ua, - ia bëri*. Me funksion të veçantë vendoset presja midis kryefjalës

³⁶ Këtu paraqiten vetëm disa shembuj të ndërhyrjeve të shumta në shenjat e pikësimit, sepse kufijtë redaksionalë të studimit e bëjnë të pamundur regjistrimin e tyre të plotë.

dhe kallëzuesit në fjalinë: 211 *Uniteti, u prish?*] 207 *Uniteti u prish?*, për të korrigjuar rendin e gjymtyrëve në fjalinë pyetëse.

Pikëpyetja vihet në vend të pikës në fjalinë pyetëse: 219 *Ku e gjen...?*] 214 *Ku e gjen...* . dhe mbyllet fjalia me një shenjë pikësimi, kur gabimisht mungon: 26 “*më kupton?*”.] 28 «*më kupton?*»

Përdorimi i shumëpikëshit në fund të vargut: 493 *radarë...*] 478 *radarë*, uniformon shenjat e pikësimit me vargjet simotra të romanit.

Viza e gjatë i paraviihet ligjëratës së drejtë: 82 *pa asnjë kujdes. – I plotë,*] 81 *pa asnjë kujdes, i plotë*, dhe hiqet kur nuk kemi të bëjmë me një ligjëratë të tillë: 119 *gjarprin. Ç’gjëra*] 116 *gjarprin. – Ç’gjëra*; 172 *të mëdha. Shakaja*] 170 *të mëdha. – Shakaja*; 336 *gjë e tillë. Mua jo*] 328 *gjë e tillë. – Mua jo.*

I shpeshhtë është uniformimi i përdorimit të thonjëzave, si pas normës ortografike, kur emrat e përgjithshëm përcaktohen nga një emër i përveçëm: 25 *sheshit “Skënderbej”*, 29 *sheshin “Skënderbej”*, 311 *Sheshi “Skënderbej”*, 422, 552 *sheshi “Skënderbej”*] 27 *sheshit Skënderbe*, 30 *sheshin Skënderbe*, 304 *Sheshi Skënderbe*, 409, 536 *sheshi Skënderbe*; 105 *bulevardi “Dëshmorët e Kombit”*] 103 *bulevardi Dëshmorët e Kombit*; 186 *rrugën “Gorki”*] 183 *rrugën Gorki*; 184 *salla “Georgievskaja”*] 181 *salla Georgievskaja*; 547 *ish-bar “Krimesë”*] 531 *ish-bar Krimesë* (DGJ: 157-158, §90).

Në thonjëza shkruhen emërtime të veçanta, si modeli i automjetit GAZ, përdorur nga udhëheqësit rusë: 181 “*Zim*”, 181 “*Nata e ‘Zimave’ të zinj*”] 178 *Zim*, 178 «*nata e Zimave të zinj*» dhe modeli i aparatit fotografik: 538 “*Fed-2*”] 521 *Fed-2*. Eliminimi i tyre bëhet kur emërtimet nuk janë emra të përveçëm të mirëfilltë por nofka: 237 *Pallati i zi*] 231 «*Pallati i zi*»; 237 *Pallati i Brigadave*] 231 «*Pallati i Brigadave*».

Thonjëzat përdoren për të cituar një ligjëratë të drejtë: 47 *për t'i thënë "mjaft tani"]* 47 *për t'i thënë mjaft tani*, tekste të lexuara në gazeta: 534 *"juda Hrushov"]* 519 *juda Hrushov e*, së fundi, për të treguar përdorimin metaforik të fjalëve: 68, 73 *"Kriza"]* 67, 72 *Kriza*; 67 *"Vanceslavi"*, 73 *"Vanceslav"]* 67 *Vanceslavi*, 72 *Vanceslav* ose 188 *"çështje klime"]* 185 *çështje klime*.

Ndeshet dhe korrigjimi i drejtë i titujve të artikujve të botuar në gazeta, duke nxjerrë jashtë thonjëzave, komentet përkatëse, që paraprihen nga viza e gjatë: 48 *"Populli këndon – shënime nga festivali kombëtar folklorik"]* 48 *«Populli këndon» shënime nga festivali kombëtar folklorik*.

Kjo analizë nuk mund të mos mbyllet me shembujt e mosndërhyrjes në korrigjimin e gabimeve tipografike në B⁵.08, si në B⁴.99: 107 -105 *Dy tri-herë* (sic) dhe 578 - 560 *të hyrja* (sic), gjë që konfirmon se teksti në të cilin është bazuar B⁵.08 është B⁴.99, i cili i pati 'trashëguar' pa i korrigjuar këto gabime nga B³.83.

Ndeshen edhe raste në të cilat B⁵.08 ndërhyr dhe korrigjon gabimet e B⁴.99: 72 *realizimin]* 71 *realizi-min* (si B³.83) dhe 304 *Atëherë]* 297 *Aëherë* (si B³.83).³⁷

³⁷ Korrigjimet e tjera të B⁵.08 në krahasim me B⁴.99 janë: 34 *çështjet e importit]* 35 *çështje e importit*; 48 *por]* 48 *par*; 48 *atmosferës]* 48 *atmosterës*; 57 *kishte thënë ai]* 57 *kish ai*; 81 *së përkohshme]* 79 *së përkohshme*; 119 *s'janë]* 117 *s'ianë*; 170 *dy-tri]* 168 *dy--tri*; 174 *hi]* 171 *dhi*; 178 *Dy-tre]* 175 *Dytre*; 185 *përmendur]* 182 *përmender*; 239 *derisa]* 233 *deri sa se*; 241 *të gëzuar]* 235 *e gëzuar*; 242 *të vajtohej]* 236 *te vajtohej*; 273 *çastin]* 268 *çasin*; 293 *fytyrës së vrerosur]* 287 *fytyrës të vrerosur*; 317 *keq dhe]* 310 *keqdh2*; 415 *Ishte]* 403 *Ishtë*; 415 *bërsitë]* 403 *bërsite*; 427 *nën]* 413 *nënë*; 466 *e por-sapushtuar]* 452 *prosapushtuar*; 491 *kooperativës së Dukatit]* 476 *kooperativës të Dukatit*; 540 *të gjithë titujt]* 524 *gjithë e titujt*. Në B⁴.99 një fragment i tekstit narrativ: *të andreqej prapë* (sic) (f. 436) është përsëritur gabimisht, i zhvendosur dy rreshta më sipër, në të

2. Botimi i vitit 2012

Botimi i gjashtë i romanit *Dimri i vetmisë së madhe* vihet në qarkullim në Tiranë nga e njëjta shtëpi botuese *Onufri* në vitin 2012 (B⁶.12). Është vëllim më vete e nuk bën pjesë në një seri të veprave të autorit (si botimi i parë -1973- dhe i dytë -1977-).

Shënimet e redaksisë mbi periudhën e shkrimit të kësaj vepre narrative e mbi dy botimet e para të saj plotësohen me një paraqitje të shkurtër, të së njëjtës redaksi, të historisë së tekstit të romanit, f. V.

Vijon *Parathënia* e veprës, me autor Éric Faye, që del në ff. VII-XIII, ndërsa *Shënimi* i Ismail Kadaresë për romanin e vet (*Romani i vetmisë / Shënim i autorit*) regjistrohët në ff. XV-XVIII.

Vëllimi përbëhet prej XVIII ff., të shënuara me numra romakë, të cilave u shtohen 505 ff. të shënuara me numra arabë. Teksti i romanit zë vetëm faqet e regjistruara me shifra arabe.

Vepra është e pajisur me tregues të lëndës: *Përmbajtja*. Numri i faqes së parë të tekstit narrativ, regjistruar aty, nuk është i saktë, sepse llogarit edhe faqet e *Parathënies* së Faye-t dhe të *Shënimit* të Kadaresë, të numëruara me shifra romake (VII-XVIII), pra automatikisht të përjashtuara nga numërimi arab. Në të vërtetë, teksti i mirëfilltë i romanit fillon në f. 3 dhe jo në f. 21 (si shkruhet në *Përmbajtje*). Ky gabim shtypi përsëritet në regjistrimin e faqes nistore të çdo *Pjese*.

Në palosjen e kapakut të përparmë dhe pjesërisht në palosjen e kapakut të prapmë botohet një *Pjesë nga një dokument i KQ të PPSH*, i datës 8 maj 1973, për romanin «*Dimri*

njëjtën faqe tipografike, duke zëvendësuar njëkohësisht një fjalë tjetër (mbiemër) të tekstit; në B⁵.08 ky togfjalësh foljor me të drejtë eliminohet dhe rishkruhet mbiemri cilësor të *befasishme* (f. 448), i rimarrë nga B³.83 (f. 462).

i vetmisë së madhe». Në dokument vepra analizohet me imtësi dhe kritikohet ashpër; romani dënohet dhe propozohet të hiqet nga qarkullimi.

Në pjesën tjetër të palosjes së kapakut të prapmë regjistronen vlerësime pozitive të romanit: gjykimi i analistit dhe shkrimtarit francez Éric Faye është marrë nga *Parathënia* e vëllimit, ff. VIII-IX, ndërsa konsideratat e historianes dhe përkthyeses ruse Nina Smirnova janë nxjerrë nga *pasthënia* e botimit rus (Moskë, 1991).

Në kapakun e prapmë shënohet fragmenti i fundit i *Shënimit* hyrës të Kadaresë: “Tridhjetë e pesë vite pas botimit të parë, të vetmit botim të pacunguar në Shqipëri, libri vjen përsëri në duart e lexuesit shqiptar, i cili sot nuk është më i ndryshëm, por i njëjtë me atë të botës së lirë.”³⁸

Struktura e botimit të gjashtë të romanit (B⁶.12) të sjell ndërmend menjëherë strukturën e botimit të pestë (B⁵.08). Përqasja krahasuese është e thjeshtë: botimi i fundit, B⁶.12, mbështetet pa dyshim te botimi pararendës, B⁵.08, dhe *nuk është një ripunim i tij*, sepse nuk ndeshen as variante tekstuale as ndërhyrje gjuhësore.

Pra, bëhet fjalë për një *ribotim të njëllajtë* qoftë të pjesës hyrëse qoftë të tekstit narrativ. Shtëpia botuese *Onufri* hedh edhe një herë në qarkullim *Dimrin e vetmisë së madhe* ndoshta për arsye marketing-u. Numri i ndryshëm i faqeve varet nga formati i ndryshëm i botimeve, por edhe nga përzgjedhja e redaksisë të përdorë numërimin romak në pjesën hyrëse të vëllimit. Janë shtuar në B⁶.12 *Përmbajtja* dhe *palosjet* e kapakut. Fragmenti i *Shënimit të Autorit*, i regjistruar në pjesën e prapme të kapakut, zëvendëson *shënimet e redaksisë së B⁵.08*.

³⁸ Khs. I. Kadare, *Dimri i vetmisë së madhe* (2012), vep. cit., f. XVIII.

Vëzhgimi i vëmendshëm i gabimeve të shtypit të B⁶.12, të marra e të përsëritura pa dashje nga B⁵.08, i cili vetë i kishte ‘trashëguar’ nga B⁴.99, duke i korigjuar ose duke i lënë të pandryshuara, vërteton hipotezën e *njëjtësisë* së dy botimeve të fundit: B⁶.12 nuk e paravendos vizën lidhëse te numërorët në f. 79: *Dy tri-herë* (sic) (gabim shtypi në B⁵.08: 107, si në B⁴.99: 105), nuk e zëvendëson zanoren e mesme qendrore ë me të mesmen e përparme e në f. 501: *të hyrja* (sic) (gabim shtypi në B⁵.08: 578, si në B⁴.99: 560) dhe i ruan ndreqjet e gabimeve të B⁵.08 te zërat: 47 - 72 *realizimin* (khs. *realizimin* në B⁴.99: 71, si në B³.83) dhe 258 - 304 *Atëherë* (khs. *Aëherë* në B⁴.99: 297, si në E³.83).³⁹

Si përfundim, ky punim, pas studimit të katër botimeve të para të romanit *Dimri i vetmisë së madhe* të Ismail Kadarese, plotëson rindërtimin e historisë së tekstit dhe hulumtimin e varianteve të veprës.

Romani, që tashmë i korrespondon ndijimit a dëshirës së Autorit, është një vepër e rinovuar dhe e përsosur në këndvështrim normativ, me një shkallë tejet të lartë të përpunimit gjuhësor, që mishërohet në risitë leksikore e në zhdërvjelltësinë shprehëse, dhe me një nivel intelektual edhe më të arrirë, që pak i ngjan tekstit fillestar. Harku kohor tri-dhjetëepesëvjeçar i ripunimit të veprës nuk mund të mos përcillte pjekurinë artistike të vetë Autorit, që më në fund i jep trajtën përfundimtare krijesës së vet.

³⁹ Të gjitha korigjimet e gabimeve të shtypit në B⁵.08 në krahasim me B⁴.99, të regjistruara në shënimin 37 të këtij studimi, ruhen identike në B⁶.12.

BIBLIOGRAFI

- DASHI B., *Il romanzo 'Dimri i vetmisë së madhe' di Ismail Kadare (Storia del testo e studio delle varianti)*, Roma 2010.
- DREJTSHKRIMI I GJUHËS SHQIPE, Akademia e Shkencave e RP të Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë 1973.
- FAYE É., *Conversazioni con Kadaré* (Tirana-Parigi, aprile-dicembre 1990), Parma 1991.
- FJALOR I GJUHËS SË SOTME SHQIPE, Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë 1980.
- FJALOR I GJUHËS SHQIPE, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë 2006.
- FJALOR I SHQIPES SË SOTME, Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë 1984.
- FJALORI DREJTSHKRIMOR I GJUHËS SHQIPE, Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë 1976.
- GRAMATIKA E GJUHËS SHQIPE, I, Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë 1995.
- KADARE I., *Dialogue avec Alain Bosquet*, Fayard, Paris 1995.
- KADARE I., *Dimri i madh*, "Naim Frashëri", Tiranë 1977.
- KADARE I., *Dimri i madh*, në *Vepra letrare*, VII, "Naim Frashëri", Tiranë 1983.

- KADARE I., *Dimri i vetmisë së madhe*, roman, “Naim Frashëri”, Tiranë 1973.
- KADARE I., *Dimri i vetmisë së madhe*, në *Vepra, Koha e grindjes* (diptik), vëllimi i shtatë, Fayard, Paris 1999.
- KADARE I., *Dimri i vetmisë së madhe*, vëllimi V, Onufri, Tiranë 2008.
- KADARE I., *Dimri i vetmisë së madhe*, Onufri, Tiranë 2012.
- KADARE I., *Pesha e Kryqit*, Fayard, Paris 1991.
- MIRACCO E., *Storia del testo del romanzo “Piramida” di Ismail Kadare*, Napoli 1999.
- SCARSELLA A., *Presentazione*, në *Leggere Kadare*, Critica, Ricezione, Bibliografia (Atti della Giornata di studi, Venezia, 13 giugno 2006), Milano 2008.

APPENDICE II

PAGINE DEL ROMANZO A CONFRONTO (PARTE I)

appena installata (*përpara disa minutash*, Ed. 83), silenziosa e solitaria, proprio perché nessuno ancora sapeva (*muk e dinte ende njeri*) della sua esistenza. La telefonata segna la rottura definitiva tra Besnik e Zana: l'uomo sconvolto ripete inconsciamente - *në mënyrë të pavetëdishme* - (*automatikisht*, Ed. 83) le parole del contadino sconosciuto (*fjalët e fshatarit të panjohur*): *Të verbër, toka humbon* (Ciechi, la terra sprofonda). Si sente vuoto e vaga senza meta (*Pas kësj, i zbrazur nga gjithçka eci nëpër dëborë*).¹³⁶

A p. 400, PT, 8 (p. 424, XIX) è descritto Enver Hoxha nel suo ufficio mentre legge un rapporto sull'alluvione: dopo il numero delle vittime, si elencano (*më poshtë renditëshin*) le case distrutte e gli ettari di terreno franato. Ai generici danni economici subentrano i più specifici danni alla ferrovia (*dëmtimet e hekturdhës*). La descrizione della mattina invernale non è introdotta dall'indicazione che Hoxha si avvicina alla finestra. Il grigiore del cielo sembra che caratterizzi non un'epoca (*Kishte diçka epokale*, Ed. 83), ma la sua fine (*Kishte diçka si prej fundepoke*); a p. 401 (p. 425) Hoxha ricorda che, intorno al tavolo rotondo a Mosca, gli interlocutori avevano agitato tra le mani fogli con citazioni di Lenin e di Marx, e adesso le stesse persone agitavano cambiali e soldi. Ma non è riportato che questo è *un antico quadro*, caratteristico di ogni *crimine*. È conservata l'ulteriore critica a loro: sarebbero passati gli anni, i loro capelli sarebbero diventati bianchi e i loro discorsi più pacati - *më të qeta* - (*më të qeta, më solemne*, Ed. 83), sarebbero accresciute le loro presenze nei presidium, nelle ricorrenze festive e negli schermi televisivi, le citazioni nei diari (*ditare*) e nei libri di memorie, le acclamazioni dei ragazzi con i mazzi di fiori, per la loro saggezza - *urtësinë* - (*dinjitetin*, Ed. 83), la cultura, l'umanità, però tutto ciò (*të gjitha këto*) non avrebbe cancellato la macchia che si erano procurati (*i kishin vënë vetes*), negando il pane a un intero popolo. Non appare che queste azioni dei politici sono un *rituale* e una *messa in scena*; a p. 401 (p. 426) è omesso il riferimento alla riunione pomeridiana, dove Enver Hoxha avrebbe parlato di Lenin, e alla preoccupazione di non fare trasparire ancora nulla sulla scissione nel suo discorso; nelle pp. 402-403 (pp. 426-427) è ritratto Hoxha intento a leggere il materiale fornitogli dai suoi collaboratori: la sua curiosità è tutta per la corrispondenza. Nel passo aggiunto, pur dichiarando che con altri dirigenti comunisti lo accomuna il tipo di corrispondenza che legge, egli reclama l'autonomia e il diritto di agire secondo la sua volontà: *Kishte një padurim për t'i hedhur një sy letrave që sekretarët, si zakonisht, ia kishin ndarë në tre grupe: të brendshme, të jashtme, anonime. Këto të fundit kishte veç dy muaj që, sipas kërkesës së tij, ia sillnin. Buzëqeshi me vete kur mendoi se*

¹³⁶ "Dopo questo, svuotato di tutto, si incamminò nella neve."

ç'mund të thoshte Hrushovi po ta merrte vesh: shoku Enver ka shkuar gjer atje sa të lexojë letrat anonime. Po të mos ishte i mërzhitur do të qeshte edhe me zë të lartë. Kishte bindjen se ata të gjithë i lexonin, ndonëse e fshihnin. Sidoqoftë tani ai ishte veç, mund të prishte zakonet e përbashkëta. Dhe jo vetëm për letrat anonime, por për gjithçka.¹³⁷ Sono riferite le persone che scrivono le lettere, ma non è riportata la denominazione del loro posto di lavoro e la provenienza: *Letrat e brendshme ishin zgjedhur, si përherë, nga punëtorë të uzinave, studentë, intelektualë me emër, malësorë.*¹³⁸ Hoxha pazientemente ne legge qualcuna: *Ndonëse e dinte ç'shkruanin: sido që të ndodhë, sido që të vijë puna, ne do të jemi përherë me partinë, gjer në fund, etj. etj., ai lexoi disa prej tyre gjer në fund. Të njëjtën gjë bëri me letrat e dy komunistëve të vjetër çekë, të një filozofi nga Zelanda e re si dhe me letrat nga Afrika, nga komunistët francezë, belgë dhe brazilianë.*¹³⁹ La sua attenzione è attirata da una lettera di cui conosce l'autore: *Ai u habit kur midis letrave anonime, njëra prej tyre, dhe pikërisht ajo më e gjata, jo vetëm e kishte emrin, por bashkë me të jepte vendin e punës: Aranit Çorraj, magazinier në Zdrukhtarinë Qendrore, ish-punonjës i Ministrisë së Brendshme.*¹⁴⁰ Non è riportato che la Falegnameria è un'azienda statale (*NSH e Zdrukhtarisë*, Ed. 83). Il Capo lo riconosce perché era stato seguace di Koçi Xoxe, il primo Ministro degli Interni dello Stato albanese (*Njeriu që kishte shkruar letrën nuk e fshihje që ishte idhtar i tij.*¹⁴¹). La riabilitazione dell'ex ministro era stata chiesta in un plenum del Comitato Centrale - *ne një plenum të Komitetit Qendror - (më 1956, në Konferencën e Tiranës - nel 1956,*

¹³⁷ "Era impaziente di dare un'occhiata alle lettere che i segretari, come al solito, avevano diviso in tre gruppi: interne, dall'estero, anonime. Queste ultime, da due mesi, dietro sua richiesta, gliel'avevano portavano. Sorrise tra sé quando pensò cosa avrebbe detto Kruščiov se ne fosse venuto a conoscenza: il compagno Enver è giunto perfino a leggere le lettere anonime. Se non fosse triste, avrebbe riso anche ad alta voce. Aveva la convinzione che tutti loro le leggevano, sebbene lo nascondessero. In ogni modo egli adesso stava a sé, poteva trasgredire le comuni abitudini. E non solo per le lettere anonime, ma per tutto."

¹³⁸ "Delle lettere interne erano state scelte, come sempre, quelle degli operai delle officine, degli studenti, degli intellettuali famosi, dei montanari."

¹³⁹ "Pur conoscendo il contenuto: qualsiasi cosa succeda, comunque si mettano le cose, noi staremo sempre con il partito, fino alla fine, ecc. ecc., egli lesse interamente alcune di esse. La stessa cosa fece con le lettere di due comunisti cechi, di un filosofo della Nuova Zelanda e anche con quelle provenienti dall'Africa o spedite dai comunisti francesi, belgi e brasiliani."

¹⁴⁰ "Egli si meravigliò, quando una delle lettere anonime, e proprio quella più lunga, non solo era sottoscritta, ma riportava anche la professione e la sede del lavoro: Aranit Çorraj, magazzino nella Falegnameria Centrale, ex impiegato nel Ministero degli Interni."

¹⁴¹ "L'uomo che aveva scritto la lettera non nascondeva di essere un suo seguace."

nella Conferenza di Tirana -, Ed. 83); nelle pp. 403-404 (pp. 428-429) non compare che il Ministero degli Interni, diretto da Xoxe, voleva sostituirsi al Partito e che faceva molta fatica per riuscirci; permane solo il riferimento alla scalata (*po ngjitej, shkarrangjitej*) ai vertici del potere, grazie anche ai suoi protettori: *Ishte i fuqishëm ngaqë pas vetes kishte jugosllavët. E pas tyre rusët.*¹⁴² Per la prima volta proprio Hoxha ammette che la dottrina è soltanto la copertura della lotta per il potere: *Më pas, ndërta vazhdonin spastrimet në Ministrinë e Brendshme, ai shumë herë kishte pyetur veten nëse e gjithë kjo ishte e lidhur vërtet me një vijë politike, siç thuhej zakonisht, apo s'ishte veç një luftë për t'i zënë vendin. Ai besonte në këtë të fundit. S'kishte kurrfarë parimesh në këtë luftë, ishin vetëm magjistricat e vjetra, që i ishin shfaqur Makbethit: gëzuash, Xoxe, ministër i Brendshëm, gëzuar Koçi, në Byro anëtar; gëzuash Koçi, që nesër bëhesh sekretar i parë.*¹⁴³ È ommesso il riferimento ai tiranni abbattuti che per vendicarsi mandano dall'oltretomba i loro mantelli insanguinati in cerca di quadri dirigenti della rivoluzione, proprio come aveva fatto il centauro Nessò che si era vendicato con il vincitore Eracle, causandogli atroci dolori con il mantello donato in punto di morte. Nessun accenno alla similitudine della rivoluzione con Saturno, che divora i suoi figli scialacquatori. Non sono menzionati gli usurpatori dello Stato, che venivano puniti ai lavori forzati nelle cave, nei magazzini, ecc. Il successivo passo aggiunto scredita Hoxha, perché lo presenta come persona che affida il suo destino al caso: *Ishin vetëm ato [shtrigat] dhe asgjë tjetër. Vijat politike s'kishin qenë veç prirje për të përligjur njeriun që do të vihej në krye. Ai vetë ishte fajësuar nga kundërshtarët e tij për të dyja: për ashpërsi, për butësi. Më 1947, kur quhej i butë dhe bëheshin gati ta rrëzonin për të vënë në krye Xoxen e ashpër; era kishte ndërruar befasisht. Dhe ai, i cillësuar një Zot e dinte pse, "i butë", kishte ngadhjnyer. Tani që po i thoshin të kundërtën, se ishte i ashpër; besonte prapë në një ndërrim ere. Dhe studimet në Francë kështu ia përmendnin, herë për mirë, herë për keq. Madje në Moskë, kjo kishte ndodhur brenda së njëjtës natë...*¹⁴⁴ Non c'è rigore

¹⁴² "Era potente perché dietro di sé aveva gli jugoslavi. E dietro di loro i russi."

¹⁴³ "In seguito, mentre continuavano le epurazioni nel Ministero degli Interni, egli molte volte si era domandato se tutto questo fosse veramente legato ad una linea politica, come si diceva comunemente, oppure fosse soltanto una lotta per usurpargli il posto. Egli credeva in quest'ultima. Non c'era alcun principio in questa guerra, c'erano solo le vecchie streghe che erano apparse a Macbeth: auguri, Xoxe, Ministro degli Interni, auguri Koçi, membro nell'Ufficio politico, auguri Koçi, domani diventerai primo segretario."

¹⁴⁴ "Erano solamente loro [le streghe] e null'altro. La linea politica non era stata che uno stratagemma per legittimare l'uomo che avrebbe governato. Egli stesso era stato colpevolizzato dai suoi avversari sia per la severità sia per la tolleranza. Nel 1947, quando era considerato mite e si preparavano a destituirlo per mettere a capo il severo Xoxe, il

nel suo atteggiamento, non c'è una presa di posizione netta, il suo camaleontismo è evidente. Nell'Ed. 99 Aranit nella sua lettera propende nuovamente per il pugno di ferro: *Njeriu që kishte shkruar letrën, ndonëse i paditur, e kishte ndier se duhej zgjedhur përfundimisht vija e ashpër, madje ajo më e skajshmja. Nuk e fshihte mallin për vitin 1947.*¹⁴⁵ Nell'Ed. 83 si trattava di una scelta sincera e probabilmente inconsapevole, ma non pericolosa; a p. 405 (pp. 430-431) si rinviene un ampliamento con cui Kadare esprime le proprie convinzioni sulle motivazioni alla base del comportamento indecifrabile di Hoxha, riconoscendogli il merito di avere svincolato l'Albania dal blocco comunista: *Të gjithë jepnin mendime si mund të dilej nga ky dimër, mendoi. I hoqi sytë nga dosja dhe porositi një kafë. Të gjithë, madje edhe të burgosurit politikë, letrat e të cilëve ishin shpeshuar kohët e fundit. Ishin disa nga lavdërimet e tyre që e trembnin më shumë se çdo gjë: më në fund ti e bërë diçka për Shqipërinë tonë, e shkëpute atë nga ajo lindja komuniste...*¹⁴⁶ Per il Capo è chiaro il da farsi, nonostante le esortazioni: *...mendja i shkoi prapë te qindra letrat që kishte marrë e te mijëra të tjerat që do t'i merrte, me siguri, ditët e ardhme. Nganjëherë nervozohet: përse njerëzit, si asnjëherë tjetër, e quanin të natyrshme të jepnin mendime se si mund të dilej nga kjo gjendje? Thua se portat e daljes ishin të pafundme... Midis letrave, sidomos atyre pa emër, kishte shpesh fraza me dy kuptime. Në njerën përshkruheshin me hollësi kullat e hershme të ngujimit në Veri...*¹⁴⁷ Segue il racconto di uno sconosciuto (*shkruante i panjohuri*) sulle persone, che uscite dalle torri, dove erano rimaste rinchiusi per molto tempo,

vento aveva improvvisamente cambiato direzione. E lui, definito, Dio sa perché, 'mite', aveva vinto. Adesso che gli dicevano il contrario, che era severo, egli credeva ancora che il vento cambiasse direzione a suo favore. Anche gli studi compiuti in Francia così glieli giudicavano, a volte a vantaggio, a volte a svantaggio. Anzi, a Mosca questo era successo nell'arco della stessa notte..."

¹⁴⁵ "L'uomo che aveva scritto la lettera, pur non essendo istruito, aveva intuito che doveva essere scelta definitivamente la linea dura, anzi quella estrema. Egli non nascondeva la nostalgia per il 1947."

¹⁴⁶ "Tutti suggerivano come uscire da questo inverno, pensò. Distolse lo sguardo dal dossier e ordinò un caffè. Tutti, perfino i prigionieri politici, le cui lettere si erano infittite negli ultimi tempi. Erano alcuni loro elogi che lo spaventavano più di ogni altra cosa: finalmente tu hai fatto qualcosa per la nostra Albania, l'hai distaccata dall'Est comunista..."

¹⁴⁷ "... gli tornarono in mente le centinaia di lettere che aveva ricevuto e le migliaia che avrebbe ricevuto sicuramente nei giorni avvenire. A volte si innervosiva: perché le persone, come mai prima, consideravano normale dare suggerimenti su come uscire dalla situazione? Come se le vie di uscita fossero infinite... Tra le lettere, specie quelle anonime, c'erano spesso frasi a doppio senso. In una erano descritte minuziosamente le antiche torri del Nord, [rifugio sicuro per proteggersi dalla vendetta]..."

